



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

I Nr. 85 Dt. 20.03.2008
PRISHTINË-A

Për: **Dr. Ali Hamiti,**
Kryetar i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ("ZRRë")

Nga: **Remzi Shahini,**
Drejtor Menaxhues i KEK Sh. A.

Kopje: **Nagip Krasniqi,**
Drejtor Financiar i KEK Sh. A

Fadil Ismajli- KOSTT


Data: 20 Mars, 2008

**Shkresa: KEK Sh. A. Komente mbi Raportin Konsultativ të ZRRë-së,
lidhur me Rishikimin e Tarifave të Energjisë Elektrike 2008**

I Nderuari, Dr. Hamiti,


**Në harmoni me rregullat e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Korporata
Energetike e Kosovës (KEK Sh. A.) paraqet komentet mbi Raportin Konsultativ të
ZRRë-së lidhur me rishikimin e tarifave të energjisë elektrike 2008.**


**Ju lutemi gjeni të bashkangjitur Komentet tona.
Me sinqeritet**


Driton Rrustemaj

**Drejtor i Zyrës për tarifa dhe
Çështje Rregullative të KEK-ut**




Remzi Shahini
Drejtor Menaxhues, KEK Sh.a.



Nr. 265108

Data. 20.03.08 ESOARD

PËRGJIGJET E KEK-ut NDAJ LETRËS KONSULTATIVE TË ZRrE-së

Letra konsultative "Rishikimi i Tarifave të Energjisë Elektrike 2008" e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) me 10 Mars 2008 ka kërkuar komente nga palët e interesuar. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a) ka opinione të ndryshme ndaj shumë propozimeve të ZRrE-së dhe dorëzon këto komente dhe përgjigje.

Modeli i të hyrave the i tarifave (MHT) është përdorur për të llogaritur të Hyrat e Lejuara duke përdorur të dhënat nga KEK-u si dhe të dhëna tjera nga versioni i mëparshëm i përdorur në procesin tariforë të vitit të kaluar. KEK-u vlerëson se koncepti i modelit ashtu siç është i prezantuar duket të jetë korrekt. Megjithatë është një dokument kompleks dhe i vështirë i programuar në Excell me shumë flet pune (42) dhe qindra ndërlihdje mes qelive në fletat e punës; që një analist tarifor me më pak përvojë do ta ketë jashtëzakonisht të vështirë të bëjë vlerësimin e saktësisë së rezultateve të modelit. KEK-u dëshiron të theksoj se në shumë raste, të dhënat, siç janë të dhënat për ngarkesës së rastësishme është e vlerësuar për secilën kategori tarifore, ndërsa modeli ka përdor të dhëna që nuk janë të dokumentuara. Kështu që KEK-u nuk ka qen në gjendje të vlerësoj nëse të dhënat e supozuara janë të arsyeshme.

Nëpër tërë përmbajtjen e dokumentit Konsultativ, ka një sërë krahasimesh me të Hyrat e Lejuara për vitin 2007 dhe të hyrat aktuale të mbledhura nga KEK-u. Përderisa kjo informatë mund të hyj në përdorim për disa qëllime, Aplikimi Tariforë është i bazuar në vitin kalendarik 2008, siç është pajtuar mes ZRrE-së dhe KEK-ut. Kjo është e pranuar në letrën Konsultative (faqe 4) nga ZRrE-ja që thekson se "krahasimi i kostove të lejuara dhe aktuale për 2007 në pjesë të madhe janë keq orientuese." Kështu që KEK-u është vënë në mëdyshje nga të gjitha këto krahasime në mes dy viteve dhe nuk beson që ato japin një pasqyrë të saktë të ndryshimeve që priten në vitin 2008. Po ashtu gjatë takimit konsultativë mes KEK-ut dhe ZRrE-së, është vendosur që tarifrat duhet të jenë kryesisht të bazuara në kostot dhe të hyrat për vitin 2008.

Të Hyrat e Lejuara

KEK-u ka dorëzuar Aplikimin e vet Tariforë bashkë me Shpenzimet Kapitale (CAPEX) dhe Shpenzimet Operative (OPEX) të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve. Rekomandimet e letrës Konsultative i kanë zvogëluar shpenzimet kapitale sepse "fondet janë zotuar". Rezultati në llogaritjen e të Hyrave të Lejuara është zvogëlimi në shumën e shpenzimeve të

zhvlerësimin dhe kthimit të lejuar. KEK-u dëshiron të theksoj se BKK ka aprovuar 79 milion € kredi dhe 38 milion € grante.

KEK-u dëshiron të theksoj se nuk e ka zvogëluar kërkesën e vet për shumën e të Hyrave të Lejuara, siç është sugjeruar në letër; rregullimet e paraqitura janë bërë nga ZRRE-ja.

Modeli Tariforë është qasje nga "lartë –poshtë" dhe është i bazuar në Bilancin Energjetik i cili është nxjerrë nga KEK-u dhe KOSTT-i. ZRRrE-ja e ka zvogëluar sasinë e humbjeve komerciale dhe ka bërë me dije se këto humbje do të konsiderohen (bëhen) shitje për konsumatorët e shpërndarjes së KEK-ut. KEK-u nuk pajtohet me zvogëlimin e "humbjeve komerciale" që përfshijnë një sasi të madhe të energjisë që i kërkohet KEK-ut tua furnizoj lokacioneve të minoriteteve (që paraqesin përafërsisht 9% të energjisë në dispozicion). Efekti i kësaj në llogaritjen e çmimeve është për të zvogëluar çmimet pasi që shumica e të Hyrave të Lejuara është e shpërndarë në më shumë kWh të shitur. Përderisa kjo mund të duket se është metoda adekuate për ta rregulluar këtë, KEK-u dëshiron të theksoj se ndryshimi i sasisë së humbjeve të lejuara për shpërndarjen nuk mundësojnë automatikisht ngritjen e shitjeve. Në fakt ka më shumë të ngjarë që KEK-u do të zvogëloj importet me kosto të lartë.

Tarifat që Kosto-Reflektuese

KEK-u mbështet propozimin e ZRRrE-së për tarifin adekuate për energjinë reaktive të furnizuar te konsumatorët e mëdhenj. Megjithatë, kostot duhet të jen të llogaritura më mirë në të ardhmen dhe tarifin të zhvillohen në mënyrë që të paraqesin kostot që janë përcaktuar nga një studim adekuat i besueshëm.

ZRRE-ja ka pranuar shumicën e rekomandimeve të KEK-ut për Ngarkesën Fikse për konsumatorët e mëdhenj, por nuk ka pranuar të njëjtat për kategoritë e konsumatorëve të konsumit të ulët. Kjo politikë nuk është në përputhshmëri me ecjen përpara drejt tarifave që pasqyrojnë koston që është propozuar nga KEK-u në aplikimin tariforë.

ZRRE-ja ka rekomanduar rritjen e çmimit të energjisë ndër-kufitare, si rrjedhojë nuk ka lëvizje drejt tarifave që pasqyrojnë koston. KEK-u beson që çmimet që pasqyrojnë koston janë adekuate pasi që japin një sinjal të duhur ekonomik te konsumatorët e energjisë elektrike. Pa këtë sinjalizim të çmimeve, është e mundur që konsumatorët të bëjnë zgjedhje që janë jo korrekte dhe që qojnë drejt konsumimit jo efikas të këti burimi të vlefshëm në Kosovë.

KEK-u nuk pajtohet me ZRrE-në që shpenzimet e "Borxhit të Keq" të përjashtohen nga llogaritja e të Ardhurave të Lejuara. Kjo është kostoja e të bërit biznes që është e pranueshme nga shumica, nëse jo nga të gjithë, rregullatorët në komunitetin ndërkombëtar. KEK-u nuk ka dijeni nëse ndonjë ndërmarrje në botë (ose ndonjë biznes tjetër sa i përket kësaj) që nuk ka një sasi të vogël të borxhit të keq që në fund të fundit paguhet nga konsumatorët tjerë.

Strukturat Tarifore

Vazhdimi i Tarifës Ditore (TD) do të qojë drejt keqpërdorimit të vazhdueshëm dhe pa asnjë përfitim për KEK-un sa i përket zvogëlimit të kostove. Sipas Modelit tariforë të ZRRE-së, konsumatorët e kategorisë 5 tarifore të tanishme, konsumojnë 56.8% të shitjeve të përgjithshme të KEK-ut me pakicë. Me një përqindje kaq të lartë të shitjeve të përgjithshme të sistemit, do të dukej adekuate që diagrami i ngarkesës së sistemit dhe diagrami i ngarkesës së grupit të kategorisë 5 të jetë mjaft të ngjashëm. Kjo tabelë paraqet ngarkesat e energjisë së sistemit për vitin 2006 krahasuar me konsumin e konsumatorëve të Grupit 5 siç është dhënë në Modelin Tariforë të ZRRE-së.

<u>Periudha e caktimit të çmimit</u>	<u>kWh</u>	
	<u>Grupi 5</u>	<u>Sistemi</u>
Sezoni Verorë i Ulët	52.95%	29.44%
Sezoni Verorë i Lartë	<u>47.05%</u>	<u>70.56%</u>
Totali	100.00%	100.00%
Sezoni Dimëror i Ulët	52.86%	34.72%
Sezoni Dimëror i Lartë	<u>47.14%</u>	<u>65.28%</u>
Totali	100.00%	100.00%

Siç paraqitet në tabelë, nuk ekziston një korrelacion i pritur në mes energjisë së sistemit për pikun (lartë) dhe jashtë pikut (ulët) dhe faturimit të kWh për këto periudha kohore. Për shembull, gjatë verës ngarkesa e sistemit gjatë periudhës së ulët paraqet më pak se 30% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Sidoqoftë, gjatë periudhës së njëjtë të përcaktimit të çmimit, faturimi i kWh për konsumatorët e Grupit 5 është mbi 52 %, gati dyfishi i sasisë së sistemit. KEK-u ia ka theksuar ZRrE-së disa herë se reletë kohore në njehsorë nuk kanë bateri ndihmëse dhe kështu për shkak të ndërprerjeve të energjisë elektrike nuk janë të rregulluara për kohën e duhur. Kjo rezulton që njehsori të regjistroj konsumin e energjisë elektrike që nuk është në harmoni me kohën adekuate gjatë çdo dite. ZRrE-ja ka bërë me

dije se ky problem mund të tejkalohet me njehsorët e rinjë, gjë që mund të jet e vërtetë përveçse kostot për të siguruar dhe instaluar njehsorët e rinjë do të jenë të tepërta.

Ruajtja e bllokut të tanishëm tariforë nuk do të mundësoj përfitime për konsumatorët e cenuar (varfër) siç është diskutuar në Aplikimin Tariforë të KEK-ut. KEK- dëshiron ta sqaroj deklaratën (faqe 13) në dokumentin Konsultativ që tregon që KEK-u propozon të eliminohet blloku tariforë; KEK-u ka propozuar të modifikohet struktura dhe të bëhet një bllok dy-tarifor në vend të bllokut tre-tarifor të tanishëm. Derisa KEK-u pajtohet me ZRRE-në se kriteri për kualifikim nuk është definuar, kjo nuk është një arsye e mirë për të refuzuar propozimin e KEK-ut dhe të fillohet të shkohet përpara drejt një politike tarifore që u mundësohet më shumë konsumatorëve të varfër dhe nuk u lejohet atyre që nuk janë të varfër që të përfitojnë nga blloku i parë më i ultë.

Çështjet Tjera

KEK-u beson se në të ardhmen KEK-u dhe KOSTT-i duhet që aplikimin tariforë ta bëjnë veçmas e jo të jen të lidhur për Modelin Tariforë të ZRrE-së. Kjo mes tjerash është në harmoni me konceptin e shthurjes. Po ashtu, konsumatorët duhet ta dinë se fatura tyre përfshin jo vetëm tarifata e ngarkuara nga KEK-u, por edhe tarifata e ngarkuara nga KOSTT-i.

KEK-u po e konsideron mundësinë e zhvillimit të modelit të vet tariforë për t'u përdorur në aplikimin e ardhshëm.